

P R I L L

2 0 2 0

MONITORIMI I AKTIVITETIT FILANTROPIK
SHQIPËRIA

EDICION
SPECIAL



M O N I T O R I M I I
A K T I V I T E T I T F I L A N T R O P I K
g j a t ë
S I T U A T Ë S C O V I D - 1 9

PRILL 2020

Partnerët Shqipëri po kryen monitorimin e aktivitetit filantropik në Shqipëri nëpërmjet hulumtimit të medias, përfshi edhe ato sociale, si dhe burimeve të informacionit nga institucionet publike dhe jo-publike. Hulumtimi kryhet mbi baza ditore dhe gjetjet paraqesin çështjet e mbështetura, natyrën e dhurimeve, si dhe natyrën e dhuruesve. Nëpërmjet këtij Edicioni Special Partnerët Shqipëri prezanton raste mbi monitorimin e këtij aktiviteti gjatë situatës së COVID-19 në Shqipëri.

Filantropi në kohë të karantinës

SITUATA AKTUALE
30 PRILL 2020

773

Raste

31

Viktima

470

Shëruar

Situata pandemike si pasojë e Covid-19 vazhdon të jetë ende prezente në mbarë globin. Shqipëria ka qenë ndër vendet të cilat fatmirësisht kanë pësuar një përmirësim të ndjeshëm, dhe dalëngadalë po vërehet një normalizim i jetës sociale dhe ekonomike në vend. Ndërkaq ne ende vazhdojmë të përballemi me një gjendje të jashtëzakonshme, e cila mbart në vetvete vështirësi të shumta, kërkesa të ndryshme, ndryshime të mëdha dhe gjithmonë nevojën për solidaritet. Fatmirësisht mbështetja dhe solidariteti nuk kanë munguar sikundër dhe përgjegjshmëria qytetare. Njerëzit janë të ndërgjegjësuar dhe shpresëplotë për të ardhmen.

Mjekët, infermierët, zjarrfikësit dhe sanitarët vazhdojnë të jenë në vijën e parë të betejës me virusin. Mirënjohja jonë për ta është e pamatë. Krahas tyre bizneset, organizatat e shoqërisë civile por dhe individë të ndryshëm kanë dhënë ndihmesën e tyre në zbutjen e pasojave të pandemisë.

Shqipëria dërgoi një grup të dytë mjekësor në Italinë fqinje, pas dërgimit të 10 mjekëve dhe 20 infermierëve rreth një muaj më parë. Një gjest ky, që sërish u përshëndet nga fqinjët italianë dhe vëtë Ministri i Jashtëm Di Maio.

Nismës shumë kreative dhe të dobishme të printimit të maskave 3D për ti ardhur në ndihmë personelit mjeksor në misionin e tij, i janë bashkuar edhe pedagogë dhe studentë të Universitetit Politeknik të Tiranës.

Psikologja Marinela Shpata, ka vënë në dispozicion aftësitë e saj profesionale për të moshuarit në Lezhë për tua lehtësuar sado pak gjendjen e tyre psikologjike dhe emocionale si pasojë e izolimit të gjatë.

Zjarrfikësit e Tiranës surprizuan mjekët dhe infermierët e Infektivit, duke shkuar pranë spitalit me disa pankarta në duar dhe duke dhënë mesazhet e tyre falënderuese për ta.

Gjithashtu rrjeti i restoranteve KFC u solidarizua me mjekët e spitalit të infektivit duke u dërguar pako ushqimore dhe krahas tyre, çdo pjesëtar i stafit të KFC shkruajti një dedikim personal për stafin mjeksor.

Që prej fillimit të pandemisë rrjeti i shpërndarjes së ushqimit 'Baboon' në bashkëpunim me disa restorante prestigjioze në Tiranë, ka mbështetur vazhdimisht me vakte ushqimore mjekët dhe infermierët e Spitalit Infektiv.

Banka Amerikane e Investimeve ndihmoi komunitetin e mjekëve dhe infermierëve duke dhuruar tre pajisje respiratore për terapi intensive, për të rritur kapacitetet në përballjen me situatën e krijuar nga COVID-19, por edhe në shenjë falenderimi për ata që janë në frontin e parë të luftës.



Një iniciativë shumë e veçantë artistike ka qënë risjellja e këngës “Bella Ciao”, si simbol i rezistencës popullore ndaj armikut të padukshëm. Pjesë e projektit ka qënë dhe këngëtarja shqiptare Irma Libohova së bashku me artistë të tjerë nga vende të ndryshme të botës si: Tommaso Primo nga Italia, Guillem Roma nga Spanja, Samah Mustafa nga Palestina, Dëëis Caldea nga Brazili, Georgios Stimpakos nga Greqia apo dhe dhe Laye Ba nga Senegali.

Teatri Kombëtar falë mbështetjes së Raiffeisen Bank Shqipëri, dhe në kuadër të Prillit të leximit shfaqti për publikun nëpërmjet ekranit të rrjeteve sociale iniciativën "The Show Must Go On". Ky projekt solli interpretime të veprave letrare botërore dhe kombëtare nga artistët më në zë të Teatrit Kombëtar.


Një tjetër nismë për të sjellë një atmosferë paksa ndryshe për bluzat e bardha dhe për pacientët e prekur nga koronavirusi ishte performanca e artistëve Marsela Çibukaj dhe Vitmar Basha, të cilët i ofruan disa momente argëtimi dhe qetësie stafit të spitalit infektiv dhe pacientëve.

Ditët e karantinës kanë frymëzuar artistët shqiptarë nga e gjithë bota për të sjellë versione të ndryshme të këngëve të repertorit kombëtar. Nisma e ndërmarrë nga dy të rinj arbëreshë, Francesco dhe Francesca Manoccio bëri bashkë një grup të rinjsh nga vende të ndryshme të botës për të sjellë këngën e njohur arbëreshe “Lule, lule”. Artistët punuan rreth 4 javë për të sjellë si dhuratë për festën e Pashkëve këtë këngë.



“Tirana këndon” solli disa koncerte të pazakonta rrugëve të Tiranës falë pjesëmarrjes së Eneida Tarifës, Denisa Xhemnicës dhe Lorenc Hasramës, të cilët performuan në kryeqytet për t’i argëtuar qytetarët e izoluar në shtëpi.

ABI Bank ka qënë sponsori kryesor në realizimin e disa eventeve artistike/kulturore online si "Opera me Pizhama" apo Grand Gala “Të gjithë e duan Agim Krajken”. Këto evente u përcollën nëpërmjet Facebookut.



Kompanitë kryesore të telekomunikacionit në Shqipëri kanë dhënë ndihmesën e tyre për të mposhtur COVID-19, kryesisht duke lehtësuar procesin e ofrimit të leksioneve të mësimit online duke ofruar pa pagesë shërbimet e tyre për aksesimin e këtyre platformave.

Albtelecom Albania bëri të mundur aksesin falas në platformën “SchoolMe” për të përfituar mësimet online deri në përfundim të vitit shkollor 2019-2020.

Telekom Albania ofroi aksesin falas në platformën edukuese të “RTSH Shkollë” që u dedikohet të nxënësve apo maturantëve, të cilët mund të ndjekin programin shkollor me lëndët kryesore të ciklit 1-12, si dhe lëndët bazike për Maturën, të gjitha këto të përcjella në ekran nga mësues të shkollave 9-vjeçare e të mesme.

Vodafone Albania pajisi me aparate smart rreth 5,000 fëmijë nga e gjithë Shqipëria që nuk kishin patur mundësi të ndiqnin shkollën online. Shpërndarja u krye nga Ministria e Arsimit në të gjithë vendin.

Krahas kësaj Vodafone prezantoi gjithashtu ‘Vodafone Home Concert’, koncerte online me të ftuar të ndryshëm të cilët do të performojnë live për të argëtuar dhe shoqëruar publikun në këto ditë të vështira.

Përprojekta e përbashkët e organizatave të shoqërisë civile, bizneseve dhe qytetarëve ka qënë vendimtare në përballimin e situatës së krijuar në vend. Fondacione si "Firdeus" apo "Fundjavë Ndryshe" janë asistuar në punën e tyre të palodhur nga biznese të shumta si : "Eurolab Internacional Grup shpk", "Kosmonte Foods Al", "Brunes", "Gjonaj Group Holding", "IuteCredit", "Sigma InterAlbanian Vienna Insurance Group", "Agro Blend", "INSIFA", "Farma Net", "MSSC sh.p.k", "Bojra Fatjon", "Avantgarde sh.p.k", "Hotel Koloseo", etj.

Disa nga bankat kryesore në Shqipëri si Banka Credins, OTP Bank apo Alpha Bank Albania i janë gjendur pranë komunitetit. Kështu OTP Albania iu përgjigj kërkesës për ndihmë nga bashkia Kamëz dhe mundësoi dërgimin në banesë të paketave ushqimore për familjet në karantinë pa asnjë burim të ardhurash. Credins Bank mbështeti Down Syndrome Albania në mënyre që të vazhdohej me terapinë e të folurës online gjatë muajit të kaluar dhe Alpha Bank Albania iu bashkua nismës së Kryqit të Kuq Shqiptar, Dega Tiranë duke kontribuar me 100 pako me ushqime dhe produkte sanitare për familjet në vështirësi.

Grupi Balfin ka treguar një përgjegjshmëri të lartë sociale duke dhënë një sërë ndihmash si mbështetja e rreth 100 familjeve në nevojë në bashkinë e Kamzës dhe dhurimi ndaj Policisë së Shtetit i rreth 10,000 maskave dhe dorezave për t'u përdorur nga forcat e policisë gjatë luftës me përhapjen e COVID-19.

Një pjesë e organizatave të shoqërisë civile që kanë mbështetur në vazhdimësi qytetarët dhe struktura të ndryshme shtetërore janë: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, i cili ka kontribuar me 5 mijë maska mbrojtëse dhe 10 mijë doreza për Policinë e Shtetit; EKO Mendje në Shkodër ka vazhduar çdo ditë që nga data 20 mars punën e saj vullnetare për të ndihmuar njerëzit që janë të izoluar në shtëpi, moshat e treta dhe familjet në nevojë duke i blerë ilaçe, bukë, apo duke u dhuruar ushqime; Down Syndrome Albania të cilët kanë mbështetur me pako ushqimore personat me aftësi të kufizuara që jetojnë në familje të varfëra dhe u asistuan në këtë mision nga *AlbanianCourier*; Food Bank Albania që u mbështet në misionin e saj për grumbullimin dhe shpërndarjen e ushqimeve shtresave në nevojë nga stafi i brendshëm i *Ambasadave hollandeze dhe greke*, kompania *AlbKalustyan*; rezidentët e *Long Hill Residence* apo dhe rrjeti i supermarketeve UniCoop Albania si dhe World Vision Albania që bashkëpunoi me disa bashki për të asistuar famijet në nevojë me paketa ushqimore dhe higjienike si dhe me paisje/produkte bujqësore.

Një ndihmesë për njerëzit në nevojë por edhe për profesionistët që vazhdojnë ende të luftojnë me pandeminë ka dhënë dhe Kryqi i Kuq Shqiptar duke operuar përmes degëve të Kruqit të Kuq në mbarë vendin. Paketa ushqimore dhe higjeno-sanitare u janë vënë në dispozicion qytetarëve në nevojë në qytetet e Tiranës, Durrësit, Elbasanit, Beratit, Vlorës, Fierit etj. Gjithashtu Policia e Shtetit është asistuar me maska të përgatitura nga vullnetarët e KK.



F i l a n t r o p i n ë k o h ë t ë k a r a n t i n ë s

Gjatë muajit prill pavarësisht kufizimeve dhe gjendjes së jashtëzakonshme që vazhduan të ishin pjesë e jetës sonë të përditshme, u vu re një përmirësim i gjithanshëm i situatës. Pati një rigjallërim të jetës sociale në vend, ulje të numrit të infektimeve dhe një zgjatje të fashave të orareve të qarkullimit. Na mbetet vetëm të shpresojmë së ky përmirësim i ngadaltë dhe konstant do të vazhdojë dhe ne do të arrijmë të adaptohemi shpejt dhe sukseshëm me realitetin tonë të ri.



Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim
www.partnersalbania.org

#Rrinështëpi